



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 64
Prishtinë, më 7 qershor 2012

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 7 QERSHOR 2012**

Mbledhjen e drejtoi **Jakup KRASNIQI**, kryetar i Kuvendit, ndërsa i ndihmoi **Sabri HAMITI**, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i deklaroi të hapura punimet e mbledhjes plenare.

Ai procedoi me rendin e ditës, të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me kryetarët e grupeve parlamentare.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Ganimete Musliu, Armend Zemaj, Albana Gashi, Ramiz Kelmendi, Fikrim Damka, Skender Hyseni, Zenun Pajaziti, Ardian Gjini, Albulena Haxhiu, Hykmete Bajrami, Fadil Demaku dhe ministri Fehmi Mujota, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti Daut Haradinaj parashtrroi pyetje për ministrin Agim Çeku në lidhje me avancimin e procesit të transformimit të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Ushtri të Republikës së Kosovës. Ministri Agim Çeku iu përgjigj pyetjes së deputetit Daut Haradinaj.

Deputetja Xhevahire Izmaku parashtroi pyetje për ministrin Nenad Rashiq në lidhje me ndërtimin e një qendre sociale të banimit për rastet me varfëri të skajshme në komunën e Vushtrrisë.

Ministri Nenad Rashiq nuk ishte i pranishëm në sallë.

Deputeti Goran Marinković parashtroi pyetje për ministrin Fehmi Mujota në lidhje me iniciativën e Ministrisë që ai e drejton për përmirësimin e gabimeve të mundshme në shenjat e komunikacionit rrugor.

Ministri Fehmi Mujota iu përgjigj pyetjes së deputetit Goran Marinković.

Në vazhdim, deputeti Lutfi Zharku, në emër të GP të LDK-së, propozoi që të hiqet nga rendi i ditës pika - **Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2011**. Ai e arsyetoi propozimin me mungesën e raportit të auditimit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2011.

Kryetari kërkoi deklarinë e grupeve parlamentare dhe Komisionit Funkcional lidhur me propozimin e deputetit Lutfi Zharku.

Në lidhje me propozimin e lartpërmendur diskutuan: Zenun Pajaziti, Adem Grabovci, Visar Ymeri, Ardian Gjini, Myzejene Selmani, Sasha Milosavljeviq, Albert Kinolli, Armend Zemaj dhe Ali Sadriu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre deklarimeve, kryetari e hodhi në votim propozimin e deputetit Lutfi Zharku. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për -----35,
Kundër -----37,
Abstenime -----2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi propozimin e GP të LDK-së për heqjen nga rendi i ditës - Shqyrtimin e Raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2011.

Në vazhdim, Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d d i t e

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mëparshme,
4. Miratimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me rolin dhe pozitën e fëmijëve në Kosovë,
5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit,
6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër,
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Komisionit për përzgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.
8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2011,
9. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Ndihmës Juridike, për vitin 2011.

3. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes plenare, të mbajtur më 31 maj 2012

Kuvendi e miratoi pa vërejtje procesverbalin e mbledhjes plenare, të mbajtur më 31 maj 2012.

4. Miratimi i rekomandimeve të Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione lidhur me rolin dhe pozitën e fëmijëve në Kosovës

Kryetari, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike, konstatoi se në mbledhjen plenare të mbajtur më 1 qershor 2012, Kuvendi ka vendosur që rekomandimet lidhur me debatin parlamentar për Ditën Ndërkombëtare të Fëmijëve, të paraqitura nga kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione, të harmonizohen me të gjitha grupet parlamentare dhe ato të miratohen në mbledhjen e sotme.

Kryetari e ftoi kryetaren e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të Pagjetur dhe Peticione që ta paraqesë tekstin e rekomandimeve të harmonizuara.

Suzan Novoberdaliu, në emër të Komisionit FunkSIONAL, e paraqiti tekstin e rekomandimeve prej tetë pikash dhe i ftoi deputetët e Kuvendit që t'i miratojnë.

Kryetari i hodhi në votim rekomandimet e propozuara. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 67,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi nxori këto:

R E K O M A N D I M E

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare, në afat sa më të shkurtër kohor, ta hartojë programin kombëtar gjithëpërfshirës për zhvillimin dhe edukimin në fëmijërinë e hershme, i cili do të garantojë zhvillimin e plotë të fëmijës si një qytetar i dobishëm dhe produktiv për shoqërinë kosovare;
2. T'i inkurajojë institucionet, si në nivel qendror, ashtu edhe në nivel lokal, duke siguruar burime njerëzore dhe financiare të nevojshme për zbatimin e politikave të nevojshme në hartimin, zbatimin, mbikëqyrjen lidhur me zhvillim dhe edukimin në fëmijërinë e hershme në Kosovë;
3. Të hartojë programe cilësore dhe edukative për prindërit, me qëllim të përmirësimit të ushqyeshmërisë, kujdesit dhe stimulimit të të nxëniet në fëmijërinë e hershme, që do të ofrohen nëpërmjet shërbimeve shëndetësore, si maternitetet dhe qendrat e mjekësisë familjare në sektorin publik dhe privat, në bashkëpunim me sektorin e arsimit dhe mirëqenies sociale;
4. Me qëllim të realizimit të të drejtave të fëmijëve, për zhvillimin e potencialit të plotë kognitiv, emocional, social, fizik dhe përgatitjen e nevojshme paraprake për shkollë, të hartojë programe edukative cilësore për prindër, edukatorë dhe kujdestarë, nëpërmjet shërbimeve që do të ofrohen nga institucionet e arsimit, në bashkëpunim me institucionet e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale;
5. Të fuqizojë shërbimet sociale për mbrojtjen e fëmijës nga çfarëdo forme e dhunës, keqtrajtimit dhe eksploatimit, si dhe mbrojtja sociale nëpërmjet ofrimit të asistencës sociale për fëmijët në nevojë;

6. Të fuqizojë zbatimin e kodeve etike nga të gjitha institucionet dhe profesionistët, të cilët punojnë drejtpërdrejt me fëmijë, si dhe mediet, për të siguruar mbrojtjen nga cenimi i të drejtave të fëmijëve;
7. Të sigurojë që në procesin e riatdhesimit, në mënyrë individuale ta shqyrtojë çdo rast, duke marrë parasysh interesin më të lartë të fëmijës, në mënyrë që të kenë qasje të barabartë në shërbime shëndetësore, arsimore dhe sociale;
8. Të hartohet Projektligji për fëmijët.

5. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit

Kryetari e ftoi përfaqësuesin e Qeverisë që para deputetëve të Kuvendit ta paraqesë dhe arsyetojë Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit.

Ministrja **Mimoza Kusari-Lila** tha se mbrojtja e konsumatorit është një komponentë e përhershme në ecuritë e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Angazhimi në avancimin e pozitës së mbrojtjes së konsumatorit paraqet një detyrim qytetërues dhe human, dhe si e tillë ajo njihet në të gjitha e vendet të botës demokratike.

Në vazhdim theksoi se miratimi i këtij projektligji do të ishte një kontribut i çmuar për krijimin e një sistemi të mirëfilltë ligjor dhe efikas, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe evropiane.

Më pas, ajo u fokusua në sqarimet për përafrimin e këtij projektligji me legjislacionin e BE-së, me ç'rast përmendi një varg direktivash të BE-së që e rregullojnë këtë fushë.

Në fund, ministrja **Mimoza Kusari-Lila** i ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë në parim Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit.

Pastaj, kryetari e hapi debatin për shqyrtimin, në parim, të Projektligjit për mbrojtjen e konsumatorit.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Sala Berisha-Shala - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Lutfi Zharku - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Mursel Halili - në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Duda Balje - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, si dhe Ganimete Musliu, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 57,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kryetari konstatoi se Kuvendi e miratoi në parim Projektligjin për mbrojtjen e konsumatorit.

Kuvendi e ngarkoi Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, si Komision FunkSIONAL dhe raportues, dhe komisionet e përhershme që ta shqyrtojnë Projektligjin brenda dy muajve dhe Kuvendit t'ia paraqesin raportet me rekomandime.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër

Kryetari i njoftoi deputetët për raportet dhe rekomandimet e komisioneve të përhershme dhe të Komisionit FunkSIONAL raportues për Projektligjin për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër.

Raportin e Komisionit FunkSIONAL për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, për Persona të Pagjetur dhe Peticione, e paraqiti deputetja Suzan Novoberdaliu.

Në vazhdim, kryetari procedoi me votimin e amendamenteve, një nga një, deri te amendamenti 9, për të cilin kishte dy propozime.

Lidhur me këtë amendament diskutuan deputetët: Safete Hadergjonaj - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Lutfi Haziri, Adem Grabovci, Albana Gashi, Sabri Hamiti, Ardian Gjini, Suzan Novoberdaliu dhe Arben Gashi, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Në mungesë të harmonizimit të qëndrimeve ndërmjet Komisionit FunkSIONAL dhe Komisionit për Buxhet dhe Financa lidhur me amendamentin e 9-të, kryetari konstatoi se **Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për personat e verbër dhe personat pjesërisht të verbër** shtyhet për mbledhjen e radhës, me qëllim të harmonizimit të qëndrimeve ndërmjet komisioneve.

7. Shqyrtimi i propozim-vendimit të Komisionit për Përzgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës

Deputetja **Safete Hadergjonaj**, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, tha se si komision e kemi shqyrtuar propozimin-vendimin e Komisionit për përzgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës dhe kemi rekomanduar miratimin në mbledhje plenare.

Kryetari e hapi debatin për shqyrtimin e propozim-vendimit të Komisionit për përzgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Behar Selimi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Ismet Beqiri - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Xhevdet Neziraj - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, Jelena Bontiq - në emër të Grupit Parlamentar SLS, ndërsa Albert Kinolli - në emër të Grupit Parlamentar “6+”, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e propozim-vendimit të Komisionit për përzgjedhjen e kryesuesit dhe anëtarëve të Bordit Drejtues të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 38,
Kundër -----21,
Abstenime ----- 5.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

I. Kryesuesi dhe anëtarët e Bordit të Fondit të Kursimeve Pensionale të Kosovës emërohen, si në vijim:

1. Ymer Havolli - kryesues,
2. Driton Qehaja - anëtar,
3. Van Driel Leendert Willem - anëtar,
4. Alan Pickering - anëtar,
5. Ruzhdi Morina - anëtar.

II. Mandati i të emëruarve nga pika **I.** e këtij vendimi zgjat tre (3) vjet, duke filluar nga data 1 gusht 2012.

8. Shqyrtimi i raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2011

Deputeti **Fikrim Damka**, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si komision e kemi shqyrtuar raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2011, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund e përkrahu raportin vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Safete Hadergjonaj - në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Ganimete Musliu - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Lutfi Zharku - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Visar Ymeri - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, si dhe Sabri Hamiti, Ardian Gjini, Valbona Dibra, Arben Gashi, Jakup Krasniqi, Muhamet Mustafa, Lutfi Haziri, Albin Kurti dhe Sali Asllanaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e raportit vjetor të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për ----- 24,
Kundër -----26,
Abstenime -----7.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Kuvendi nuk e miratoi raportin vjetor i Agjencisë Kosovare të Privatizimit, për vitin 2011.

9. Shqyrtimi i raportit vjetor të Komisionit të Ndihmës Juridike, për vitin 2011

Deputeti Behar Selimi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, tha se si komision e kemi shqyrtuar raportin vjetor të Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2011, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai në fund e përkrahu raportin vjetor të Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2011.

Për këtë pikë të rendit të ditës diskutuan edhe deputetët: Behar Selimi - në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Armend Zemaj - në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Albulena Haxhiu - në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Ardian Gjini - në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Myzejene Selmani - në emër të Grupit Parlamentar të Koalicionit Kosova e Re, diskutimet e të cilëve janë dhënë të plota në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryetari e hodhi në votim miratimin e raportit vjetor të Komisionit për Ndihmë Juridike, për vitin 2011.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 53,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 2.

Kryetari konstatoi se Kuvendi me shumicë votash e miratoi raportin vjetor të Komisionit të Ndihmës Juridike, për vitin 2011.

Kryetari i deklaroi të mbyllura punimet e mbledhjes plenare në orën 14:25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Procesverbalin e hartoi:

Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale